

HOMELIA E DATËS 29 TETOR 2022 NE SHKODER

400 VJETORI I PROPAGANDA FIDE

Imzot Angelo Massafra ofm
Arqipeshkev

Në përfundim të muajit kushtuar nga ne katolikët lutjes, ndërgjegjësimit dhe bashkëpunimit misionar kemi dashur të kujtojmë, si dhe në vende të tjera të botës, 400-vjetorin e krijimit të Kongregatës “de Propaganda Fide”, e themeluar nga Papa Gregori XV ne vitin 1622 e njohur sot si Dikasteri i Ungjillizimit të Popujve.

Edhe Ati i Shenjtë Françesku e kujtoi këtë ngjarje në Mesazhin e tij që na ka drejtuar me rastin e Ditës Misionare Botërore duke përdorur këto fjalë: *“Themelimi Propaganda Fide, në vitin 1622, u motivua nga dëshira për të promovuar mandatin misionar në territore te reja. Një intuitë providence! Kongregata rezultoi vendimtare për ta bërë misionin ungjillëzues të Kishës me të vërtetë të tillë, domethënë të pavarur nga ndërhyrja e fuqive të kësaj bote, për të krijuar ato Kisha lokale që sot tregojnë kaq shumë energji. (...) I njëjti Shpirt, që drejton Kishën universale, frymëzon gjithashtu burra dhe gra të thjeshta për misione të jashtëzakonshme. Dhe kështu ndodhi që një vajzë franceze, Pauline Jaricot, themeloi Shoqatën për Përhapjen e Besimit saktësisht 200 vjet më parë; (...) Nga kjo ide brilante lindi Dita Botërore e Misionit që ne festojmë çdo vit dhe lemoshat te mbledhur në të gjitha komunitetet është i destinuar për fondin universal me të cilin Papa mbështet veprimtarinë misionare”.*

Prej veprimit të *Propaganda Fide-s* ka përfituar edhe Kisha në Shqipëri që nga viti 1622 deri në vitin 2005, me dërgimin e misionarëve, me kontributin ekonomik famullitareve dhe famullive gjate pushtimit otoman, me themelimin e Seminarit Ilirik në Fermo (Itali), me edukimin e meshtarëve për veprimin e vështirë misionar në malet e Shqipërisë dhe të Bosnjë-Hercegovinës. Meshtarët formoheshin edhe ne Kolegjin e Loretos. Propaganda fide ka kërkuar gjithmone raportet meshtarëve shqiptarë edhe Vizitatorëve Apostolike të dërguar nga Selia e Shenjtë. Dhe pas lirise nga vite 1991-2005 Propaganda fide ka kontribuar shume per ndertimin e kishave, kuvendeve dhe strukturave te tjera.

Falë angazhimit të *Propaganda Fide-s* mbërritën në Shqipëri Fretërit e parë Minorë të Reformës Serafik, si misionare, dhe në Kolegjin Papnor Urbanian e Propaganda Fides në Romë shumë prej Martirëve tanë (jemi në ditët e Nëntëditëshes në përgatitje të festës së tyre!) kanë përfunduar formimin e tyre meshtarak. PER KETE NJE FALENDERIM TE MADHE PROPAGANDA FIDES.

Papa i shton edhe vepra të tjera *Propaganda Fide-s*, si *Vepra e Fëmijërisë së Shenjtë* për të promovuar misionin mes fëmijëve dhe që ende sot ofron ndihmë të rëndësishme Kishës sonë në Shqipëri; *Vepra e Shën Pjetrit Apostull* në mbështetje të seminaristëve dhe të meshtarëve në tokat e misionit; *Unioni Misionar Papnor* për të sensibilizuar dhe për t’i frymëzuar për mision meshtarët, rregulltarët dhe rregulltaret dhe krejt popullin e Hyjit. Dhe Papa Françesku e mbyll mesazhin duke thënë: *“Shpresoj që Kishat vendore të gjejnë në këto Vepra një mjet të fortë për të ushqyer shpirtin misionar në Popullin e Hyjit”.*

Vëllezër dhe motra, ne jemi kjo Kishë vendore për të cilën flet Papa Françesku; prandaj, përkujtimi i këtyre përvjetorëve të lidhur me ndërgjegjësimin dhe veprimin misionar të Kishës do të thotë kryesisht të ringjallet tek ne para së gjithash vetëdija se nëse Kisha nuk është misionare nuk mund të quhet “Kishë”: është një koncept bazë që e kam përsëritur edhe me rastin e festës së Zojës së Shkodrës dhe që duhet të bëhet gjithnjë e më shumë motivi kryesor i jetës sonë të krishterë.

Na e ka kujtuar edhe Shën Pali në leximin e parë që kemi dëgjuar: të jetosh apo të vdesësh nuk ka rëndësi; rëndësi ka që Krishti të shpallet. Fjalë të forta që nuk lënë asnjë fije dyshimi për rëndësinë e kësaj të vërtete teologjike mbi natyrën misionare të Kishës.

Dhe përsëri, sipas mësimit të Palit apostull, kumtimi kalon përmes lavdërimit të Krishtit në trupin tonë si besimtarë: jemi ne të pagëzuarit që mbartim vulën e Krishtit në vetvete, në mënyrë që ajo të shihet prej të gjithëve. Kjo do të thotë se çfarëdo veprimi që të bëjmë, si individë apo të gjithë së bashku, si bashkësi besimtarësh, duhet të bëhet për dashuri të Krishtit dhe për lavdërimin e Krishtit.

Por që kjo të jetë e mundur, është po aq e rëndësishme që të zhvillojmë tek ne një dëshirë të madhe për Zotin, një dashuri të madhe për të, të aftë për t'i çuar jetët tona në një nivel më të lartë. Ky është kuptimi i “etjes” për të cilën na këndoi psalmi: “*Shpirti im ka etje për Hyjin e gjallë*”. Etjen për Zotin, dëshirën për Të, mund ta kuptojmë si dëshirën e të dashuruarit për të jetuar i bashkuar me të dashurën, për të pasur të njëjtat ndjenja si e dashura, për të dashur atë që ajo do. Nëse ne e duam Hyjin, do të kemi të njëjtat ndjenja dhe të njëjtën dëshirë që “*të shëlbohen të gjithë njerëzit dhe t’ia arrijnë njohjes së të vërtetës*” (1 Tim 2, 4).

Në këtë kuptim, i krishteri e zbaton në mënyrë të përsosur urdhrin e Zotit Jezus, kur - siç na mëson Ungjilli i njërës prej të dielave të kaluara - e konsideron veten një “shërbëtor të padobishëm”, domethënë pa “fitim”, pa përfitim personal, sepse fitimi i vërtetë i të krishterit është bashkimi me Zotin, duke qenë në tryezë me Të. Dhe këtu del e vertete edhe thënia tjetër e Jezusit: “*Lum shërbëtorët që, kur kthehet zotëria, i gjen zgjuar! Përnjëmend po ju them: ai vetë do të ngjeshet, ata do t’i ulë në tryezë do të afrohet dhe vetë do t’i shërbejë*” (Lk 12, 37). Pak a shumë kuptimi i Ungjillit të sotëm ku të përvuajturit i jepet vendi i parë nga miku i dashur që e fton të ecë më përpara.

Jemi në mes të operacionit të gjatë dhe të rëndësishëm që Papa Françesku donte për Kishën universale, atë të Sinodit, që synon të ringjallë vetëdijen tonë se i përkasim Popullit të Zotit në mënyrë të plotë dhe aktive. Edhe ne, si Kishë e kësaj toke shqiptare e kemi pyetur veten se si është gjendja aktuale, se si po e jetojmë përkatësinë dhe pjesëmarrjen tonë në jetën dhe në Misionin e Kishës. Shumë nga ato aspekte pozitive dhe negative që u theksuan në raportet përfundimtare i kanë rrënjët në të kaluarën e popullit tonë; një të kaluar që, falë arkivave të *Propaganda Fide*-s, mund ta studiojmë për të kuptuar më mirë të tashmen tonë, edhe pse në situata të ndryshuara historike dhe sociale.

Me fjalët e Virgjërës Mari, “*Shpirti im e madheron Zotin...*” edhe ne sot te them: “Shpirti yne e madheron Zotin... për të gjitha të mirat që ka bërë në Kishën tonë në Shqipëri nëpërmjet *Propaganda Fide*-s dhe për këtë kremtim.

Është një tjetër mundësi që Zoti, në mirësinë dhe provaninë e Tij, na ofron që të rizbulojmë bukurinë e të qenit tonë të krishterë; dhe t’i lutemi me gjithë forca tona që ta plazmojmë zemrën tonë me fuqinë e Shpirtit Shenjt, që ta bëjë atë të zjarrtë me dashuri për Të, plotësisht sipas vullnesës së Tij, për ta shpëtuar mbarë njerëzimin dhe te jemi plot me zell për shpëtimin e shpirttrave.

Kështu do ta shpëtojmë edhe shpirtin tonë, që më në fund do të gëzojë prej gëzimit dhe paqes së bashku me shumë vëllezër e motra, të shpëtuar si ne dhe me Zotin e tij për amshim.

Atij nderi dhe lavdia në shekuj të shekujve.